



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER**

**NJOFTIM
PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN SHOFER**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kërkon të punësojë **1 (një) punonjës në administratë me detyrë “Shofer”**.

Bazuar në ligjin nr. 97/2016, datë 06.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

NJOFTON:

Fillimin e procedurës së hapur për konkurrim të hapur të kandidatëve për **1 (një)** vend vakant në pozicionin **“Shofer”**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe të mos jetë apo të mos ketë qënë nën hetim;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në marrëdhënie pune dhe/ose shërbim civil, që nuk është shuar sipas ligjit;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm.
- Të njoh Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
- Të njoh ligjin “Për Prokurorinë”;

2. Kushtet e posaçme:

- Të zotëroje patentë të **klasit B**.
- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie punë efektive me stafin e prokurorisë.
- Të ketë aftësi komunikuese.
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, **deri më datën 12.01.2026 ora 16.00, këto dokumenta:**

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaport;
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar ;
- d) Diplomë e shkollës së mesme ;
- e) Dëshmi penaliteti;
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria, që nuk ndiqet penalisht;
- g) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provoj punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja;
- h) Vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore.

Pranimi i dëkumentacionit të dorëzuar nga kandidatet do të behët në Zyrën e Protokollit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, **deri me datën 29.01.2026 ora 16.00.**

Konkurimi për vendin e punës në pozicionin “ Shofer” do të zhvillohet në dy faza :

Faza e parë: verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, e cila realizohet nga Kryesekretari i kësaj Prokurorie me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim.

Kandidatët të cilet nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë: Intervista.

Vlerësimi i kandidatëve nga komisioni do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat si dhe rezultati i intervistës.

-Dokumentacioni 60 pikë

- Intervista 40 pikë

Në përfundim të vlerësimit të kandidateve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, do të njoftoj kandidatët individualisht për rezultatet.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER**